

VENDIM
Nr. 567, datë 6.10.2021

PËR MËNYRËN E PROKURIMIT TË MALLRAVE, PUNËVE E TË SHËRBIMEVE, NË KUADËR TË VEPRIMTARIVE TË CEREMONIALIT SHTETËROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të pikës 4, të nenit 11, të vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, dhe të vendimit nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e ceremonialit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucioni i Presidentit të Republikës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Kryeministria, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të prokurojnë mallra, punë dhe shërbime, sipas përcaktimeve të ceremonialit shtetëror të Republikës të Shqipërisë dhe të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, në kuadër të organizimit të veprimtarive të veçanta dhe të përditshme me karakter protokollar e ceremonial.

2. Prokurimet për kategorinë e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i nënshtrohen procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, sipas dispozitave të legjislacionit për prokurimin publik, nëse vlera e përlogaritur për artikuj apo grup artikujsh, brenda një viti kalendarik, është nën kufirin e ulët monetar. Kjo procedurë prokurimi nuk zhvillohet me mjete elektronike.

3. Institucioni i Presidentit të Republikës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Kryeministria, për blerjen e biletave të udhëtimit dhe akomodimit të Kryeministrit, të Presidentit dhe të kryetarit të Kuvendit dhe personelit ndihmës e shoqërues të tyre, për vizitat zyrtare në kuadër të ceremonialit shtetëror, kontraktjnë drejtpërdrejt një ofrues shërbimesh që plotëson kushtet e konfidencialitetit. Në çdo rast, marrësi i shërbimit duhet të sigurohet që çmimet e shërbimeve të mos jenë mbi çmimet e tregut.

4. Vendimi nr. 358, datë 24.4.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e prokurimit të mallrave, punëve e të shërbimeve, në kuadër të veprimtarive të ceremonialit zyrtar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohen institucioni i Presidentit të Republikës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Kryeministria, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj